



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1259 Prot.

Tiranë, më 16.06.2026

VENDIM

Nr. 45 Datë 16.06 2026

**“PËR
MIRATIMIN E NXJERJES JASHTË PËRDORIMIT TË AKTIVEVE PËR VITIN 2026 NË
UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS**

Mbështetur në nenin 49 të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" të ndryshuar, me Udhëzimin nr. 20 datë 17.11.2014, nr. 11 datë 06.05.2016 nr.24, datë 07.12.2016, kreu IV "Sistemi i kontrollit periodik të Aktiveve", në nenin 43 të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, në Vendimin e Senatit Akademik me nr. 81 datë 22.05.2026 "Mbi miratimin e rregullores për menaxhimin e aktiveve në Universitetin e Sporteve të Tiranës", në relacionin nr. 3115/3 prot, datë 02.06.2026 të Komisionit të Inventarizimit dhe Vlerësimit, në relacionin nr. 3115/4 prot, datë 11.06.2026 të Administratorit, Bordi i Administrimit me Vendim Qarkullues datë 16.06.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e nxjerjes jashtë përdorimit të Aktiveve të Universitetit të Sporteve të Tiranës për vitin 2026, sipas tabelës bashkangjitur;
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtorja e Financës dhe Buxhetiti, Drejtorja e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademike-Shkencore të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur ÇOBANI

